



Para se të raportosh, mendo sikur ai fëmijë të ishte fëmija yt!

Linda Pino

Media e shkruar dhe ajo vizive sa vjen e çdo ditë po luan një rol të madh në jetën e gjithsecilit prej nesh. Rritja e përdorimit të teknologjisë dhe internetit ka lehtësuar së tepërmi aksesin në informacion, duke i “veshur” medias dhe petkun e ndërgjegjësuesit të publikut për tema sociale që në një mënyrë apo tjetrën prekin jetën e secilit prej nesh.

Nëse vite më parë kronikat me në qendër shkeljen e të drejtave të fëmijëve kanë qenë të pakta në numër, krahasuar me dinamikën e kronikave me karakter politik apo kronikave të zeza të larjeve të hesapeve mes bandave dhe krimit, sot media e shkruar dhe ajo vizive po i kushton sa vjen e më tepër vëmendje raportimit të rasteve të fëmijëve viktime të dhunës seksuale, abuzimit, trafikimit apo dhe shfrytëzimit të tyre.

Nga njëra anë mund të pranojmë se raportimi dhe publikimi në media i historive rreth abuzimit, shfrytëzimit apo trafikimit të fëmijëve kanë dhënë kontribut në njohjen e fenomeneve, përmirësimin e legjislacionit dhe politikave kombëtare, rritjen e llogaridhënies të institucioneve përgjegjëse për mbrojtjen e fëmijëve, por shpesh “etja e ekskluzivitetit të lajmit” dhe mënyra e raportimit të ngjarjeve, në vend që të mbrojnë fëmijën dhe interesin e tyre më të lartë, i vendosin fëmijët në rrethana aspak lehtësuese-përkundrazi i ri-traumatizojnë ata.

***Shkurt 2019** “14-vjeçarja u përdhunua për 3 muaj, adoleshentët e shantazhonin me video, gjykata i lë në burg”*

***Shkurt 2019** “Si ndodhi ngjarja e Kavajës- zbardhen dëshmitë në Prokurori”*

***Qershor 2020** “Rrëfimi ekskluziv/ Edhe shoqja e 15-vjeçares u abuzua seksualisht: Gjithçka nisi te shkolla, si më gënjyen dy vajza, më dhanë drogë dhe...”*

***Shtator 2020** “Nëna e vajzës që u abuzua seksualisht: E lame me mirëbesim”*

***Dhjetor 2020** “Ekskluzive/ “Më futi në dhomë dhe...”! Flet vajza e abuzuar seksualisht në Kuçovë”*

***Maj 2021** “U abuzua seksualisht për 4 muaj, detaje të reja nga ngjarja në Mirditë”*

Qershor 2021 “Rrëfëhet e reja që u abuzua seksualisht në moshën 12-vjeçare: Më tha do të të çoj prostitutë në mal dhe me ty do bëj ndonjë lek”

Këta janë vetëm pak tituj, nga moria e shumë të titujve që sot rëndom i gjen me një kërkim të thjeshtë në internet. Tituj që nxisin kureshtjen për këdo, por kur fillon dhe lexon artikujt apo dëgjon emisionet mbetesh i shokuar jo vetëm nga vepra kriminale e kryer ndaj vajzave viktimë, por dhe për mënyrën sesi gazetarët i kanë ndërtuar këto kronika.

Në pjesën më të madhe, gazetarët tregohen “të kujdesshëm” duke fshehur identitetin e viktimës, por shpesh për “ një klikim më shumë” apo “audiencë më të lartë” gazetarët ekspozojnë familjarët e viktimës “me zë dhe figurë”, duke i intervistuar ata me imazh të qartë dhe përfshijnë në kronika pamje nga vendbanimi i viktimës apo dhe nxjerrin detaje nga dosja hetimore.

Kodi i Transmetimit për Median Audiovizive¹, parashikon se Ofruesve të Shërbimeve Mediatike Audiovizive (OSHMA) u ndalohej çdo raportim apo transmetim që çon direkt apo indirekt në identifikimin me zë dhe pamje, me gjeneralitete, adresë apo përkrahje të çdo fëmije që mund të jetë ose është viktimë, dëshmitar, i hetuar, i akuzuar apo i deklaruar fajtor për kryerjen e një veprë penale, përveç rasteve me interes publik. Ndërkohë, po në Kod sanksionohet që “të dhënat e publikuara për fëmijët në media duhet të shmangin: identifikimin dhe inicialet e fëmijës; identitetin e prindërve, apo të çdo të afërmi që bën të mundur identifikimin e fëmijës; rrethana, detaje mbi ngjarjen, që bëjnë të mundur identifikimin e fëmijës, cenojnë dinjitetin e tij dhe nuk i shërbejnë interesit publik; emër shkollë, kopshti, institucioni në rastet kur situata e abuzimit apo veprës penale nuk kanë ndodhur në institucion; emrin e autorit të krimit, i cili ka marrëdhënie gjaku me viktimën.” Për më tepër qartësisht Kodi, u ndalon OSHMA-ve transmetimin e pamjeve denigruese të fëmijëve, si edhe i detyron këto të fundit vendosjen e rregullave të forta për arkivimin dhe shpërndarjen e materialeve dhe filmimeve me fëmijë.

Nëse shoqëria shqiptare shpesh karakterizohet si një shoqëri ku “çudia më e madhe 3 ditë zgjat”, të jeni të bindur që historia e abuzimit të një fëmije e hedhur në internet, detajet e veprës penale të kryer ndaj fëmijës dhe të raportuara në kronika mbeten atje gjithë jetën. Sot, kur interneti i lejon lexuesit të gjejnë histori dekada më vonë, trauma që i shkaktohet një fëmije viktimë e dhunës seksuale dhe abuzimit është akoma më e madhe se kurrë. Një gjurmë e lënë në internet sot, do e ndjekë fëmijën gjatë gjithë jetës si i rritur, aq më tepër kur shërbimet në funksion të rehabilitimit të fëmijës për të tejkaluar traumën e dhunës janë ende shumë të kufizuara. Andaj, lind e nevojshme që secili prej gazetarëve duhet të reflektojë fillimisht së brendshmi rreth mënyrës se si do e ndërtojë kronikën, kjo për të mos pasur në

¹ <http://ama.gov.al/wp-content/uploads/2018/05/Kodi-i-Transmetimit-p%C3%ABr-Median-Audiovizive.pdf>

“ndërgjegjen e vet” shkatërrimin e jetës që mund të jetë duke i bërë një fëmijë “për hir të një klikimi sipërfaqësor”.

Imagjinoni se si do të ndihet një fëmijë që ka bërë një përpjekje të madhe për të tejkaluar traumën e dhunës që ka përjetuar, kur vite më vonë gjen detaje nga historia e dhimbjes së tij/saj. Shpesh organizata të shoqërisë civile dhe psikologë kanë argumentuar se gazetarët duhet të mendojnë mënyrën e duhur për të raportuar dhunën që një fëmijë ka përjetuar, kjo për të mbrojtur fëmijët viktime sot dhe në të ardhmen e tyre si të rritur nesër.

Ndërkohë që Kodi ndalon transmetimet e intervistave, ku faktet e mbledhura dhe publikimi i tyre rrezikojnë jetën, shëndetin, arsimimin, mirëqenien fizike, emocionale morale të fëmijës, kronika të tëra, emisione u realizuan rreth rastit të adoleshentes 15 vjeçare të abuzuar seksualisht nga roja i një shkolle publike, po ashtu abuzimi seksual i vajzës nga njerku, apo rasti tjetër i abuzimit të vajzës nga miku i familjes. Asnjë prej mediave nuk respektoi Kodin e Transmetimit, shkeli haptazi kodin e etikës, e ndërkohë asnjë reagim nuk u vu re nga ana e institucioneve monitoruese përgjegjëse.

Të vendosur përballë këtyre situatave, në raportimin e rasteve të krimeve ndaj fëmijëve, të rasteve të abuzimit, fëmijë në situatë rruge një gazetar profesionist duhet që fillimisht të vendosë veten “në këpucët” e fëmijëve që janë viktime, duke pyetur veten se si do të donte që fëmija e tij, motra apo vëllai i tij të trajtohej nga media, duke mos bërë premtime, apo dhurata fëmijës apo përfaqësuesit të tij ligjor me qëllim mundësimin e intervistimit. Çdo gazetar duhet të bëhet mbrojtësi i interesit më të lartë të fëmijës si edhe respektojë kërkesat morale e ligjore për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve.

Asnjë media apo gazetar nuk duhet të identifikojë një fëmijë nën moshën 18 vjeç, i cili/e cila është viktimë apo dëshmitar në raste që përfshijnë abuzim seksual ose forma të tjera të abuzimit apo neglizhimit. Dhe për më tepër sikundër dhe Kodi i Etikës i Gazetarit parashtron: “Gazetari duhet të respektojë të gjitha parimet e konfirmuara në Konventat Ndërkombëtare për të Drejtat e Fëmijëve dhe legjislacionin shqiptar mbi të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve dhe të personave me aftësi të kufizuara”

Ji zwrri i fwmijwve kur raportohen apo shkruan pwr ta!

Çdo gazetar e di shumë mirë se “fjala e lirë” është mjet i fuqishëm që i jep shumë fëmijëve të tjerë kurajë për të folur dhe raportuar çdo shqetësim apo vështirësi që mund të jenë duke kaluar. Transmetimi i përgjegjshëm i informacioneve rreth dhunës, abuzimit, shfrytëzimit mund të inkurajojë të tjerët që ndodhen në situata të ngjashme të mposhtin frikën dhe të kërkojnë ndihmë.

Bëni të pamundurën që gjatë raportimit të mos trajtoni fëmijët si viktime, të pafuqishëm apo të vetmuar. Shoqëria jonë vazhdon ende të trajtojë vajzat e dhunuara seksualisht si “shkaktare” të asaj çka janë duke kaluar, prandaj në situata të tilla, fëmijët kanë nevojë për

mbështetje, të ndihen të përkrahur dhe të mos përjetojnë asnjë “ndjesi faji” kur në fakt ato janë viktimat e tjetër kush fajtori.

Mos përdorni fjali të cilat kriminalizojnë fëmijët viktimë të abuzimit seksual apo trafikimit e për më tepër ndërtoni kronikën në mënyrë që ajo të mos cenojë besueshmërinë e viktimës. Shmangni sa më tepër dhënien e detajeve, për të mos e shndërruar tragjedinë e vajzave në një klikim te përkohshëm apo audiencë, pasi tragjedia që këta fëmijë dhe familjarët e tyre janë duke përjetuar është më e thellë se aq.

E nëse mundesh, përdor “fjalën e lirë” si mjet për të fuqizuar publikun për të mbrojtur fëmijët dhe për të siguruar një shkollë, komunitet, qytet më të sigurt për ta!

Ndërkohë që profesioni i gazetarit të rrëmben në rrjedhën e përditshmërisë së tij, mos harro që përveç se një profesionist, je një motër, vëlla, apo prind.

Ai fëmijë për të cilin je duke shkruar mund të jetë fëmijë yt!